

UDHËZUES PËR PUNONJËSIT E MBROJTJES SË FËMIJËS

MASAT E MBROJTJES PËR FËMIJËT VIKTIMA TË TRAFIKIMIT



UDHËZUES PËR PUNONJËSIT E MBROJTJES SË FËMIJËS

MASAT E MBROJTJES PËR FËMIJËT VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Korrik 2024

ISBN:

Botuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Sheshi "Italia", Tiranë

Tel: +35542240001

E-mail: pm-al@osce.org

© 2024 Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Të drejtat e autorit: Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose të rishtypet, me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e botimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të Prezencës së OSBE-së.

Autore:

Jonita Kabashi

Juliana Rexha

Marina Meshi

Dizenjimi: Florian Bregu

INFORMACION LIGJOR:

Materialet e përfshira në këtë botim, janë vetëm për informacion të përgjithshëm të ofruara për një kontekst specifik. Pikëpamjet e shprehura në të janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Përmbajtja

1. Rreth këtij Udhëzuesi	07
2. Për kë është ky Udhëzues?	08
Shkurtime	09
3. Çfarë është trafikimi i fëmijës	10
3.1 Përkufizimi dhe format e shfrytëzimit	10
3.2 Trafikimi online	11
4. Mekanizmat për identifikimin dhe referimin e rasteve	12
4.1 Mekanizmi Kombëtar i Referimit të Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit	12
4.2 Funksionimi në praktikë i MKR-së	12
4.3 Anëtarët e MKR-së	13
4.4 Autoriteti Përgjegjës	13
4.5 Procedurat Standarde të Veprimit në zbatim të MKR-së	14
5. Identifikimi i fëmijës si viktimë trafikimi - hapi i parë drejt procesit të mbrojtjes	15
5.1 Fëmija viktimë e mundshme trafikimi	15
5.2 Përse është i rëndësishëm identifikimi i fëmijës si viktimë trafikimi	15
5.3 Identifikimi i viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet punës në terren	16
Njësitë Lëvizëse	16
Skuadrat e terrenit	18
5.4 Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit	18
5.5 Raportimi i rastit	20
5.6 Veprimet e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijeve kur ai/ajo ka kontaktin e parë me një viktimë trafikimi	21
6. Intervista për identifikimin fillestar të fëmijës si viktimë e mundshme trafikimi	22
6.1 Përgatitjet për intervistën fillestare	22
6.2 Zhvillimi i intervistës fillestare të fëmijës	23
6.3 Hapat pas intervistës fillestare të fëmijës	24
7. Identifikimi Formal	26
7.1 Përse shërben identifikimi formal	26
7.2 Roli i Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës në fazën e Identifikimit formal	27

8. Sigurimi i mbrojtjes së menjëhershme	29
Shërbimet e emergjencës ndihmojnë në:	30
Hapat e punonjësve të qendrës së emergjencës:	30
9. Periudha e rehabilitimit dhe e riintegrit	32
9.1 Riintegrimi	32
9.2 Çështje dhe konsiderata të veçanta në ndihmën e fëmijëve të trafikuar në fazën e riintegrit dhe përfshirjes	34
9.3 Plani individual i mbrojtjes	35
a) Fëmija asistohet në familje	35
b) Fëmija asistohet në strehëza/qendrat për viktimat e trafikimit	36
Dëshira e fëmijës / bashkëpunimi me familjen	37
10. Dokumentimi i rasteve	39
10.1 Procedura e ruajtjes dhe dokumentimit të të dhënave	39
10.2 Dosja individuale e fëmijës në nevojë për mbrojtje	40
11. Raportimi	42
12. Lista dhe kontakte të shërbim ofruesve për fëmijë viktimë/viktima të mundshme trafikimi	44
Shtojca	46



1. Rreth këtij Udhëzuesi

Ky Udhëzues për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës pranë Njësive për Mbrojtjen e Fëmijës në nivel bashkie, përmban një përmbledhje të procedurave, udhëzimeve, rekomandimeve mbi identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të një kategorie të veçantë të fëmijës në nevojë për mbrojtje, siç është fëmija viktimë e trafikimit.

Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës është në qendër të ndërhyrjeve që lidhen me mbrojtjen e fëmijës viktimë trafikimi apo në rrezik për t'u trafikuar, që nga identifikimi i rastit, komunikimi, bashkërendimi me strukturat e tjera për sigurimin e mbrojtjes së menjëhershme dhe afatgjatë të fëmijës. Realizimi i këtyre detyrave nga ana e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës kërkon një njohje të thelluar të koncepteve dhe parimeve që udhëheqin punën me fëmijë të trafikuar, për të garantuar në çdo hap interesin më të lartë të fëmijës dhe për t'i ofruar fëmijës të drejtat e posaçme si viktimë e këtij krimi. Nisur nga kjo premisë, ky Udhëzues u vjen në ndihmë punonjësve në nivel bashkie por dhe strukturave qendrore si një dokument orientues për tërësinë e hapave që duhen ndërmarrë në lidhje me fëmijët e trafikuar. Udhëzuesi përmbledh dhe shtjellon veprimet e ndryshme që duhet të ndërmarrë Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës, në bashkërendim të ngushtë me strukturat e tjera të mbrojtjes së fëmijës, për të garantuar mbrojtjen e çdo fëmije në rrezik apo viktimë e trafikimit dhe shfrytëzimit.

Udhëzuesi është hartuar nga Jonita Kabashi, Përgjegjëse e Sektorit për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Tiranë, Juliana Rexha, Oficere Kombëtare për Anti-Trafikimin, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, dhe Mariana Meshi, Drejtore e Qendrës “Të ndryshëm dhe të Barabartë” si pjesë e veprimtarisë së OSBE-së për adresimin e fenomenit të trafikimit nëpërmjet një qasjeje shumëdisiplinore dhe të mbështetur tek të drejtat e viktimës së trafikimit.

Udhëzuesi është hartuar në kuadër të projektit të OSBE-së “Fuqizimi i kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese për hetimin, ndjekjen penale dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për masat ndaj trafikimit të personave”, financuar nga qeveritë e Norvegjisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Italisë.



2. Për kë është ky udhëzues?


Ky Udhëzues mund të përdoret nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës në bashki, për mbrojtjen e kësaj kategorie të veçantë fëmijësh duke u bazuar në detyrat që burojnë nga legjislacioni për fëmijët dhe Procedurat Standarde të Veprimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit. Procesi i mbrojtjes së fëmijës së trafikuar dhe shfrytëzuar kërkon një sërë veprimesh koordinuese ndërmjet strukturave të ndryshme në nivel qendror dhe vendor, të cilat kërkojnë ndërveprim mes strukturave vendore por dhe atyre qendrore. Kur bëhet fjalë për fëmijët në rrezik apo ata të trafikuar dhe shfrytëzuar, sistemi i mbrojtjes së fëmijës funksionon në sinergji me Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit, si strukturë e posaçme për trajtimin e rasteve të trafikimit. Ndaj Udhëzuesi u vjen në ndihmë dhe anëtarëve të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, përfshirë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, e cila ka rolin përgjegjës për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në vend.

Udhëzuesi praktik për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve ka për qëllim të fuqizojë profesionistët me njohuritë, mjetet dhe mbështetjen që u nevojiten për të identifikuar, referuar, ofruar mbrojtjen e menjëhershme dhe menaxhimin afatgjatë të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, viktimë/viktima të mundshme trafikimi.

Ky udhëzues synon të paraqesë procedura të qarta dhe të lehta për profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve për të menaxhuar në mënyrë efektive rastet e trafikimit të fëmijëve. Dokumenti fokusohet në hapat praktikë të cilat duhen ndjekur nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve nga identifikimi i një fëmije që është viktimë e trafikimit apo shfrytëzimit, deri në rehabilitimin dhe riintegrimin e plotë të fëmijës.

Shkurtime

AP	Autoriteti Përgjegjës
AP/AP	Anëtari Përkatës i Autoritetit Përgjegjës
ASHMDF	Ajencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DRKM	Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinar
G/SPIF	Grupi/ Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MKR	Mekanizëm Kombëtar i Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit
NJMF	Njësia Për Mbrojtjen e Fëmijëve
NjVNj	Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësie administrative
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës
PSV	Procedura Standarte të Veprimit për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit
RSH	Republika e Shqipërisë
SHTP	Spektori për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme (i Policisë së Shtetit)
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VT	Viktimë e trafikimit
VMT	Viktimë e mundshme e Trafikimit
ZKKAT	Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafikim
ZRSHSSH	Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror



3. Çfarë është trafikimi i fëmijës



3.1 Përkufizimi dhe format e shfrytëzimit

Trafikimi i fëmijës është abuzim i fëmijës. Kur një punonjës i strukturave të mbrojtjes së fëmijës ndeshet me një fëmijë që mund të jetë i trafikuar, duhet të njoftojë menjëherë strukturat e policisë. Çdo fëmijë, shtetas shqiptar apo i huaj apo pa shtetësi, që ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë gëzon të drejtën për mbrojtje sipas ligjit shqiptar.

Trafikimi i fëmijës (i të miturit¹) përkufizohet si:

Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 128/b

Elementët e trafikimit të fëmijës



Fëmija nuk mund të konsiderohet kurrë se ka dhënë pëlqimin për t'u trafikuar, pavarësisht marrëdhënies që ka me trafikantin/shfrytëzuesin dhe pavarësisht nëse ka bashkëpunuar me të.

- Trafikimi nuk kërkon domosdoshmërisht zhvendosjen e të miturit. Për shembull, fëmija mund të trafikohet dhe shfrytëzohet nëpërmjet internetit.
- Nëse ka zhvendosje të fëmijës, kjo mund të jetë si brenda territorit të vendit - i njohur si "trafikim i brendshëm" apo duke kaluar kufijtë ndërshtetërorë – i njohur si "trafikim ndërkombëtar".
- Nuk është e nevojshme të ketë ndodhur shfrytëzimi që vepra e trafikimit të konsiderohet e kryer. Pra, një fëmijë i cili shpëtohet para se të ndodhë shfrytëzimi, gjithsesi konsiderohet viktimë trafikimi.

Format e shfrytëzimit të fëmijës

FORMAT E SHFRYTËZIMIT TË FËMIJËS SË TRAFIKUAR

- shfrytëzimi i prostitucionit;
- forma të tjera të shfrytëzimit seksual;
- shfrytëzimi i punës ose shërbimeve të detyruara;
- skllavërimi ose forma të ngjashme me skllavërimin;
- vënia në përdorim ose transplantimi i organeve;
- forma të tjera të shfrytëzimit

¹ Fëmijë dhe i mitur përdoren në të njëjtin kuptim në këtë Udhëzues, duke iu referuar çdo personi nën moshën 18 vjeç.

Renditja e formave të shfrytëzimit mbyllet me “forma të tjera të shfrytëzimit”. Kjo sepse fëmija i trafikuar mund t'i nënshtrohet njëkohësisht më shumë se një prej formave të shfrytëzimit.

Ka raste që një fëmijë mund të jetë njëkohësisht në situatë shfrytëzimi për lypje dhe shfrytëzimi seksual. Arsyetja tjetër pse lista e formave të shfrytëzimit është joshteruese është sepse shfaqen forma të tjera të reja të shfrytëzimit të panjohura në kohën e hartimit të legjislacionit. Në kohën e hartimit të instrumenteve ndërkom-bëtare mbi trafikimin, shfrytëzimi online nuk ishte ende një problem ndërsa në ditët e sotme është një prej formave më të përhapura të shfrytëzimit.



3.2 Trafikimi online

Trafikimi i fëmijëve po ndodh gjithnjë e më shumë online, i manifestuar në dy forma kryesore:

- Trafikimi i **lehtësuar** nga teknologjia
- Trafikimi **nëpërmjet përdorimit** të teknologjisë (ose *kibernetik*)

Forma e parë është trafikimi më *'tradicional'* për të cilin trafikantët përdorin shërbimet e platformave online për të rritur kapacitetin e tyre për të rekrutuar apo kontrolluar viktimat e trafikimit. Për shembull, rrjetet sociale, lojrat online dhe platformat e komunikimit të menjëhershëm përdoren për **rekrutimin** e fëmijëve duke zgjeruar mundësitë e trafikantëve për përzgjedhjen e viktimave, duke ofruar mjete të reja për mashtrimin e viktimave dhe mbajtjen e tyre nën kontroll. Metodatat e rekrutimit që ekzistojnë shumë përpara përparimeve në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit - joshja e vajzave të reja nëpërmjet propozimeve për lidhje romantike, ofertat e rreme për punësim - tani shfaqen online dhe në shkallë më të madhe. Po ashtu, shantazhi i viktimave për publikimin e materialeve me natyrë seksuale shpesh përdoret si një mjet për rekrutimin dhe shtrëngimin e viktimës.

Në rastin e shfrytëzimit për punë, platformat online përdoren rëndom për të postuar reklama mashtruese për punë. Jo vetëm që reklamata fillestare duken të vërteta (edhe nëse ndoshta janë shumë të mira për të qenë të vërteta në disa raste), nuk ka nevojë që trafikantët të shfaqen online: shërbimet e punëtorëve të detyruar zakonisht nuk kanë nevojë të reklamohen te palët e treta në të njëjtën mënyrë si shërbimet seksuale.

Trafikimi nëpërmjet përdorimit të teknologjisë përfshin shfrytëzimin e viktimave përmes mjeteve online.

Transmetimi i drejtpërdrejtë (*livestreaming*) i abuzimit seksual të fëmijëve është një shembull si trafikimi mund të mundësohet nga teknologjia. I njohur gjithashtu si “abuzimi i drejtpërdrejtë nga distanca”, kjo lloj forme abuzimi përgjithësisht ka karakter ndërkombëtar dhe në disa juridiksione përkufizohet si trafikim. Viktimat zakonisht janë fëmijë apo të rinj/reja që jetojnë në kushte të varfra. Klienti që pagon këtë lloj shërbimi përgjithësisht është në një shtet tjetër dhe dikush tjetër siguron kontaktin midis klientit dhe viktimave të shfrytëzuara dhe familjes ose miqve të afërt të viktimës që kryejnë shfrytëzimin kundrejt një pagese.

Trafikimi i qenieve njerëzore, përfshirë kur lehtësohet ose mundësohet nga teknologjia, mund të shihet si një treg, megjithëse i paligjshëm, ku njerëzit (ose shërbimet e tyre) trajtohen si mallra.

Platforma të ndryshme online ofrojnë infrastrukturën për tregje të tilla. Për shembull, në faqet e njoftimeve, shërbimet seksuale shiten si një mall përkrah celularëve dhe makinave të përdorura; këto ‘tregje’ kanë din mikat e veta ashtu si hapësirat e tjera tregtare online².

2 OSCE, “Mapping the online landscape of risks of trafficking in human beings on sexual services websites across the OSCE region” [OSBE, “Hartëzimi i panoramës online të rrisqeve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe shërbimeve seksuale në rajonin e OSBE-së”]: <https://www.osce.org/files/f/documents/b/4/555441.pdf>



4. Mekanizmat për identifikimin dhe referimin e rasteve



4.1 Mekanizmi Kombëtar i Referimit të Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit

Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit (MKR) është një kuadër bashkëpunimi nëpërmjet të cilit institucionet shtetërore përbushin detyrimet për të mbrojtur dhe të drejtat e njeriut të personave të trafikuar (viktima trafikimi), duke bashkërenduar përpjekjet e tyre në një partneritet strategjik me shoqërinë civile.

MKR siguron procesin e **identifikimit dhe referimit** të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit për asistencë, ndërkohë që sigurohet **mbrojtja** e të drejtave të tyre.

MKR-ja siguron që mbrojtja e të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të garantohet nga një sistem efektiv mbrojtjeje dhe siguron njëkohësisht ndjekjen penale të trafikantëve.

Të drejtat e viktimave të trafikimit që mbrohen nga MKR-ja përfshijnë, ndër të tjera:

- identifikim dhe referim të sigurt;
- mbrojtje nga diskriminimi;
- ndihmë juridike falas;
- mbrojtje të të dhënave personale e të jetës private;
- të drejtë për informim;
- sigurim të strehimit, të kujdesit shëndetësor,
- social;
- periudhën e rikuperimit dhe të reflektimit;
- lejen e përkohshme apo të përhershme të qëndrimit;
- dëmshpërblim;
- të drejtën e azilit apo mbrojtjes nga kthimi i pasigurt në vendin e origjinës;



4.2 Funksionimi në praktikë i MKR-së

Zbatimi i MKR-së realizohet nga Grupi Ndërinstitucional i Punës për Bashkërendimin e MKR-së, i cili përbëhet nga përfaqësues të secilës prej palëve në Marrëveshje dhe drejtohet nga Drejtuesi më i lartë i strukturës antitrafik në Ministrinë së Brendshme.

Struktura përgjegjëse antitrafik në Ministrinë e Brendshme shërben si Sekretariat Teknik i Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe Task Forcës.

Në nivel të veprimeve të anëtarëve të MKR-së përsa i përket referimit në procesin e identifikimit, referimit për ndihmë, mbrojtje, riintegrim të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe përgjegjëse për regjistrimin dhe raportimin periodik të të dhënave për rastet e trafikimit të referuara nga institucione shtetërore dhe organizatat, është ngritur **Autoriteti Përgjegjës, si strukturë mbështetëse e MKR-së**.

Monitorimi i zbatimit të Marrëveshjes kryhet nga **Task Forca për Marrëveshjen**, e cila drejtohet nga Zëvendësministri i Brendshëm, përgjegjës për masat kundër trafikimit të personave. Task Forca për Marrëveshjen përbëhet nga një përfaqësues i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues në secilin nga institucionet shtetërore palë.

Marrëveshja për MKR-në e firmosur në qershor 2023, parashikon për herë të parë dhe këshillimin me të mbi-tjetuarit e trafikimit nëpërmjet **Bordit Këshillimor të Viktimave të Trafikimit**, i cili funksionon nën drejtimin e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Anti-trafik. Ky koalicion siguron që rekomandimet e dhëna nga viktimat në takimet konsultative i paraqiten anëtarëve të MKR-së.



4.3 Anëtarët e MKR-së

MKR funksionon në bazë të marrëveshjes së firmosur në qershor 2023 ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile, e cila zëvendësoi marrëveshjen e mëparshme dhe zgjeroi gamën e shërbimeve për viktimat e trafikimit. Anëtarë të kësaj marrëveshjeje janë:

- Ministria e Brendshme
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Drejtësisë
- Prokuroria e Përgjithshme
- Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit
- Organizata Psiko-Sociale “Vatra” - Vlorë
- Organizata “Të Ndryshëm & të Barabartë” – Tiranë
- Organizata “Tjetër Vizion” - Elbasan
- Organizata “Nisma për ndryshim shoqëror ARSIS” – Tiranë
- Organizata Ndërkombëtare “World Vision” - Tiranë
- Fondacioni Mary Ward Loreto (MWL) – Tiranë
- Organizata “Terre des Hommes”




4.4 Autoriteti Përgjegjës

Autoriteti Përgjegjës (AP) është struktura mbështetëse e Mekanizmit Kombëtar të Referimit në procesin e identifikimit, referimit për ndihmë, mbrojtje, riintegrim të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe përgjegjëse për regjistrimin dhe raportimin

periodik të të dhënave për rastet e trafikimit të referuara nga institucione shtetërore dhe organizatat, në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit.

Në praktikë, **çdo institucion që identifikon një viktimë të mundshme trafikimi, informon menjëherë anëtarin përkatës në Autoritetin Përgjegjës**, në bazë të përcaktimeve të bëra në Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.

Anëtarët e AP-së mblidhen periodikisht apo për raste të caktuara për të siguruar koordinimin ndërmjet strukturave anëtare të MKR-së dhe për të udhëzuar mbi trajtimin e rasteve që kanë nevojë për koordinim e diskutim mes anëtareve të MKR-së.




4.5 Procedurat Standarde të Veprimit në zbatim të MKR-së

Identifikimi, referimi dhe mbrojtja e viktimave të mundshme të trafikimit në Shqipëri, bazohen në **Procedurat Standarde të Veprimit (PSV)**, të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 499, datë 29.8.2018 «Për Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit». PSV-të mbulojnë të gjitha format e shfrytëzimit dhe trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, për fëmijë apo të rritur.

PSV-të kanë parashikuar procedurat specifike për secilin sektor për identifikimin dhe referim, përfshirë punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve.

Zbatimi i PSV-ve është detyrim i të gjitha institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, që punojnë në vend apo janë me mision shtetëror jashtë vendit. Veprimi në përputhje me këto procedura është gjithash-tu detyrim edhe i gjithë agjencive joshtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në çdo moment në të cilin ato, gjatë veprimtarisë së tyre, bien në kontakt me një person që dyshojnë se mund të jetë trafikuar apo informohet tek ata se është viktimë/viktimë e mundshme trafikimi, duhet të vihen menjëherë në kontakt dhe të konsultohen me autoritetin përgjegjës.



5. Identifikimi i fëmijës si viktimë trafikimi - hapi i parë drejt procesit të mbrojtjes



5.1 Fëmija viktimë e mundshme trafikimi

“Identifikimi Fillestar”, i bazuar në treguesit e trafikimit dhe intervistimin e fëmijës përcakton nëse fëmija është **viktimë e mundshme e trafikimit**. **Mjetet për identifikimin fillestar janë treguesit e trafikimit dhe intervista fillestare bazuar në formatin e Procedurave Standarte të Veprimit**

Çdo punonjës i strukturave të mbrojtjes së fëmijës duhet t’u përmbahet udhëzimeve të përgjithshme të mëposhtme:

- Të jetë gjithmonë i vetëdijshëm për mundësinë e përballjes me viktimë të mundshme të trafikimit dhe/ose shfrytëzimit.
- Të vlerësojë mundësinë se edhe pas rasteve të thjeshta në dukje të migracionit të parregullt, punës në rrugë apo lypjes, parregullsive në vendin e punës për fëmijët e punësuar dhe situatave dhe rrethanave të tjera të ngjashme, mund të fshihet një histori trafikimi, dhune dhe shfrytëzimi për punë ose shfrytëzimi seksual.
- Të kryejë një vlerësim paraprak të moshës së viktimës së mundshme (duke qenë se të miturit shpesh deklarojnë në mënyrë të rreme moshën madhore, duke shfaqur edhe dokumente të rreme), duke ndjekur udhëzimet procedurale.
- Të marrë parasysh se dispozita e trafikimit të fëmijës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë (neni 128/b) thekson qartë se pëlqimi i fëmijës për shfrytëzim është i panevojshëm për të provuar trafikimin dhe nuk duhet të ndikojë në asnjë mënyrë në njohjen e statusit të viktimës.
- Të shmangë qëndrimet agresive.
- Të kujdeset për plotësimin e nevojave parësore të fëmijës, duke iu drejtuar mundësisht shërbimeve sociale përkatëse, me vëmendje të veçantë për nevojat shëndetësore dhe të sigurisë së fëmijës.



5.2 Përse është i rëndësishëm identifikimi i fëmijës si viktimë trafikimi

Identifikimi i hershëm i fëmijës viktimë e trafikimit është hapi i parë drejt sigurimit të ndihmës dhe mbrojtjes përkatëse. Nëse një fëmijë nuk identifikohet menjëherë si viktimë trafikimi apo viktimë e mundshme, kjo do të thotë që të lejohet shfrytëzimi dhe shkeljet e të drejtave të fëmijës të vazhdojnë.

Kuadri ynë ligjor ofron të drejta të posaçme për fëmijët viktimë të trafikimit përveç se shërbimeve apo mbrojtjes më të përgjithshme që u garantohet fëmijëve në nevojë për mbrojtje për shkak të formave të tjera të abuzimit.

Qëllimi kryesor i identifikimit si viktimë trafikimi nuk është marrja e provave që i shërbejnë procesit penal ndaj trafikantit apo mbledhja e të dhënave për qëllime statistikore. Qëllimi i identifikimit si viktimë trafikimi është të vihet në lëvizje mekanizmi shtetëror i mbrojtjes dhe të gjitha shërbimet.

Mbrojtja dhe shërbimet i sigurohen fëmijës viktimë e mundshme trafikimi, pavarësisht bashkëpunimit me organet e drejtësisë.

Është e rëndësishme që identifikimi i fëmijëve viktimë të trafikimit të kryhet nga specialistë të mbrojtjes së fëmijëve që rrjedhin ose janë të lidhur drejtpërdrejt me sistemin kombëtar të mbrojtjes së fëmijëve. Ata duhet të trajnohen posaçërisht për identifikimin e fëmijëve vulnerabël dhe fëmijëve viktimë të trafikimit dhe për këtë arsye të aftë për të aplikuar metoda të përqendruara të drejtat e fëmijëve, të përshtatshme për moshën dhe duke treguar ndjeshmëri për traumën.

Në kontaktin e parë me një fëmijë që mund të jetë viktimë trafikimi, parimi kryesor që mbizotëron mbi çdo parim tjetër është **mbrojtja e fëmijës nga rreziku i mëtejshëm.**

Identifikimi i viktimave të trafikimit sipas Procedurave Standarte të Veprimit ka dy faza, faza e identifikimit fillestar dhe faza e identifikimit formal.



5.3 Identifikimi i viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet punës në terren

Identifikimi **proaktiv** i viktimave të trafikimit kryhet nga profesionistë të angazhuar nëpërmjet skuadrave të koordinuara, të përshkuara si më poshtë:

Njësitë Lëvizëse

Njësitë Lëvizëse funksionojnë sipas *Standarteve të Shërbimeve të Njësive Lëvizëse për Identifikimin dhe Referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit*, i hartuar nga organizata “Të Ndryshëm dhe Të Barabartë” në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Qështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave.

Qëllimi i krijimit të Njësive Lëvizëse për Viktimat e Trafikimit është identifikimi proaktiv i viktimave të trafikimit dhe personave vulnerabël (lehtësisht të cënueshëm) ndaj trafikimit dhe referimi i tyre sa më i shpejtë tek ndihma në përputhje me parashikimet në Procedurat Standarde të Veprimit.

Veprimet e Njësive Lëvizëse për identifikimin fillestar të viktimave përshkruhen në Seksionin e Veçantë të Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin e Viktimave të mundshme të trafikimit nga Njësitë Lëvizëse (VKM 499/2018) “Njësitë e përbashkëta të koordinuara (njësitë lëvizëse, skuadra terreni, task forca, institucionet e kujdesit rezidencial dhe ditore, institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare jo anëtare të MKR-së me/pa programe për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit”)

Njësitë Lëvizëse, të ngritura nga organizatat Të Ndryshëm & Të Barabartë, Tjetër Vizion dhe Vatra, veprojnë në qarqet *Tiranë, Shkodër, Kukës, Peshkopi, Vlorë, Elbasan, Lezhë, Durrës dhe Berat*. Njësitë përbëhen nga dy profesionistë psikologë ose punonjës socialë të dy gjinive të ndryshme, dhe drejtohen nga drejtuesit e Njësive që janë profesionistë me përvojë në menaxhim të shërbimeve në fushën e anti-trafikimit.

Njësitë Lëvizëse punojnë në terren për **identifikimin e hershëm** të viktimës së trafikimit dhe lehtësimin e heqjes së menjëhershme nga situata e shfrytëzimit si dhe referimi në shërbime. Ekipi bashkëpunon me Policinë e Shtetit, përkatësisht me Sektorin për Hetimin e Trafiqueve të Paligjshme – bazuar në marrëveshje midis organizatave të lartpërmendura dhe Policisë së Shtetit, ku parashikohet një pikë kontakti në Sektorin për Hetimin e Trafiqueve të Paligjshme në Drejtorinë Vendore të Policisë. Ekipi bashkëpunon gjithashtu me bashkinë dhe institucionet e tjera në nivel vendor.

Në qarqet ku veprojnë, puna e Njësisë Lëvizëse konsiston në:

- Identifikimin e zonave të marxhinalizuara dhe që kanë prevalencë më të lartë të trafikimit të qënieve njerëzore;
- Zhvillimin e treguesve të trafikimit për grupe të veçanta;
- Krijimin e rrjetit të informuesve në zona të ndryshme;
- Takimet me Partnere të Mundshëm që mundësojnë identifikimin dhe referimin;
- Takimet me Grupe të Margjinalizuara;
- Marrja e referimeve të individëve në nevojë për mbrojtje, individë në rrezik trafikimi, të dyshuar si viktima;
- Identifikimi i individëve në nevojë për mbrojtje, individë në rrezik trafikimi dhe referimi i tyre në shërbime sipas nevojave;
- Kontaktimi i individëve të referuar nga struktura të tjera dhe realizimi i intervistave fillestare;
- Zhvillimi i intervistave fillestare për rastet me tregues të trafikimit;
- Informimi të Autoriteti Përgjegjës i rasteve të identifikuara si viktima/viktima të mundshme trafikimi;
- Kërkesa për identifikim nga Policia të Policia Vendore;
- Referimin tek Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës/Struktura e Bashkisë e rasteve në nevojë për mbrojtje;
- Pjesëmarrja në takimet e Komitetit Rajonal Anti-Trafikim, Grupit Teknik Ndërsektorial në rastin e fëmijëve;
- Zhvillimi i takimeve sensibilizuese vetëm ose me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijës dhe partnerë të tjerë;
- Shpërndarja e ndihmës materiale në rast nevojë

Skadrat e terrenit

Skadrat e Terrenit janë të ngritura në nivel vendor për të trajtuar posaçësisht rastet e fëmijëve në situatë shfrytëzimi.

Mënyra e funksionimit të tyre parashikohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 129/2019, *"Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge"* në zbatim të Ligjit 18/2017 *"Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"*.

Nisur nga detyrimi ligjor që buron nga ky ligj *"bashkitë kanë detyrimin kryesor për marrjen e masave dhe sigurimin e burimeve njerëzore e financiare për organizimin e punës në terren për identifikimin proaktiv të rasteve të fëmijëve në situatë rruge"*, strukturat në bashki zbatuese të këtyre detyrimeve janë:

- *Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore* është përgjegjëse për organizimin e veprimtarisë lidhur me planifikimin e punës në terren, marrjen e masave për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e rasteve të fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge.

Kjo strukturë ka si detyrë:

- ✓ Hartëzimin, një herë në vit, të zonave ku ndodh shfrytëzimi;
 - ✓ Ngritjen e grupeve të skuadrave të terrenit;
 - ✓ Caktimin e koordinators të skuadrave të terrenit;
 - ✓ Hartimin dhe miratimin e planit të punës së skuadrave të terrenit;
 - ✓ Shkëmbimin e të dhënave me policinë dhe Inspektoratin e Punës;
 - ✓ Pajisjen e skuadrave të terrenit me mjetet e punës për realizimin e procedurave të parashikuara në këtë vendim;
- **Skuadra e terrenit** në bashki përbëhet nga punonjës socialë të strukturave të mbrojtjes së dhe/ose përf-qësues të organizatave jofitimprurëse.

Detyrat e Skuadrës së terrenit:

- ✓ Mbikëqyr zonat më të frekuentuara nga fëmijët që shfrytëzohen ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge;
- ✓ Jep ndihmën e parë dhe bën vlerësimin e shpejtë të rastit;
- ✓ Raporton me shkrim brenda 24 orëve nga momenti i identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje të ko-ordinatori i skuadrës së terrenit dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijës;



5.4 Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit

Treguesit e trafikimit shërbejnë për identifikimin fillestar të fëmijës viktimë trafikimi. Nëse vlerësimi i treguesve të trafikimit është pozitiv, atëherë ka arsye të besohet se fëmija është viktimë e mundshme e trafikimit.

Një fëmijë viktimë e mundshme trafikimi është rrjedhimisht **një fëmijë në nevojë për mbrojtje**. Identifikimi fillestar mund të kryhet nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, mësuesit, ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor, strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Azilin dhe Antitrafikimin, Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkërkuarit, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, si dhe vetë fëmijët.

NJMF-të dhe PMF-të kanë për detyrë të kryejnë identifikim proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet planifikimit të punës në terren, verifikimit të njoftimit të marrë nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijën, si dhe verifikimit të informacionit për rastet që vijnë në dijeni nëpërmjet medias së shkruar, elektronike apo medias sociale. (Shiko: Formulari i identifikimit proaktiv - aneksi nr. 1, VKM 578/2018).

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV), parashikojnë për çdo strukturë tregues për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimi. Për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor listohen treguesit si më poshtë për fëmijët:

- Është i/e sjellë nga një vend tjetër për të punuar/ nxjerrë më shumë para;
- Ka lëvizur i/e paregjistruar asnjëherë në gjendje civile;
- Largohet shpesh nga shtëpia;

- Fëmija vetë, prindërit e tij/saj dhe motra vëllezër kanë qenë shpesh në kontakt me policinë dhe NJMF-në si pasojë e ekspozimit, pësimit të dhunës;
- Ka një numër të kufizuar kontaktesh;
- Kalon pjesën më të madhe të kohës në rrugë duke shitur, duke lypur, duke punuar;
- Fëmijës i merren të ardhurat nga lypja, puna, veprimtaria nga më të rriturit;
- Është i punësuar në mënyrë të paligjshme, punon në punë të rrezikshme;
- Ka shenja dëmtimi që tregojnë se i mituri punon;
- Ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;
- Shfaq frikë, është i/e tërhequr;
- Ka mosbesim tek autoritetet;
- Tregon histori të ngjashme dukshëm të mësuara;
- Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund të ketë moshën ose paraqitjen për t'u përgjigjur vetë;
- Është i/e veshur keq, i/e paushqyer, i/e pakujdesur, pa gjumë të mjaftueshëm;
- Deklaron se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, dhe i shfrytëzuar;
- Ka shenja në trup, (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;
- Nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm;
- Fle në rrugë/është kapur duke vjedhur;
- Frekuenton vende të njohura për aktivitete të paligjshme (shpërndarje droge, ushtrim prostitucioni, shkëmbim mallrash të vjedhura, etj);
- Lyp duket i/e lënë pas dore, është i/e kequshqyer/veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apo kushtet atmosferike;

Gjithashtu Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës i referohen Formularit të Vlerësimit dhe Analizës së Rrezikut, duke patur në vëmendje faktorët e riskut (Shiko: Aneks Nr.6, VKM 578/2018).

Për çdo profesionist të mbrojtjes së fëmijës, këto tregues nuk duhen vlerësuar si shterues por të arrijnë të vlerësojnë në mënyrë të thelluar tregues fizikë, socialë, të sjelljes, të shfrytëzimit dhe të kushteve të jetesës. Këta tregues shërbejnë si një guidë për identifikimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje si viktimë/viktimë e mundshme e trafikimit dhe referimin pranë organeve ligjzbatuese.

Rast ilustrues

Psikologja e shkollës 9 vjecare X në Bashkinë X raporton në formë elektronike dhe me telefon pranë Punonjësës për Mbrojtjen e Fëmijës rastin e fëmijës S.G.J, 14 vjeç.

Sipas raportimit të psikologes së shkollës vihet re një ndryshim në sjelljen dhe veshjen e vajzës, ka mungesa dhe largime nga orët e mësimi. Gjatë muajit të fundit vajza është parë pranë shkollës në praninë e djemve më të rritur në moshë, e shoqëruar nga makina luksoze. Nga informacioni i marrë nga bashkëmoshatarët e vajzës, ajo punon në një lokal natën.




5.5 Raportimi i rastit

Referuar legjislacionit të mbrojtjes së fëmijëve, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, **duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit.**

Çdo mësues, ofrues i shërbimit psikosocial shkollor, punonjës i institucioneve shëndetësore apo i përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë njësisë arsimore vendore, drejtorit të institucionit, organeve të Policisë së Shtetit, strukturave për mbrojtjen e fëmijës.

Për rastin ilustrues më sipër psikologja e shkollës vendos në dizeni edhe Koordinatorin pranë Zyrës Vendore Arsimore dhe drejtorin e shkollës. Shkolla vendos në dizeni Anëtarin Përkatës në Autoritetin Përgjegjës dhe Punonjësin për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkinë/njësinë administrative ku ndodhet shkolla dhe/apo ka vendbanimin fëmija.

Në Procedurat Standarde të Veprimit listohen institucionet përgjegjëse për identifikimin e rasteve të fëmijëve viktimë/viktima të mundshme të trafikimit dhe lidhja e tyre në detyrimin për të referuar pranë Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës, Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës pranë Bashkisë ose Njësisë Administrative:



Lista e institucioneve më lart përmendur nuk duhet të jetë shteruese. Rastet e fëmijëve viktimë/viktima të mundshme trafikimi mund të raportohen edhe nga Prokuroria, struktura private, organizata të shoqërisë civile, media, linja të këshillimit, qytetarë, etj.

Në rastet e fëmijëve viktimë ose viktimë të mundshme trafikimi, institucioni i cili bën identifikimin, përveç raportimit pranë Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës, bën raportimin edhe pranë pikës së kontaktit të institucionit përfaqësues në Autoritet Përgjegjës.



5.6 Veprimet e Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve kur ai/ajo ka kontaktin e parë me një viktimë trafikimi

- Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në treguesit e identifikimit fillestar, struktura e mbrojtjes sociale në bashki/punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve njofton Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (AShMDF).
- Në rast se konstaton se fëmija ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, punonjësi e kërkon asistencën e shërbimit shëndetësor.
- Siguron menjëherë përmbushjen e nevojave bazë të fëmijës.
- Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës, i vetëm ose punonjësi i shërbimeve sociale bashkë me Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijës - zhvillojnë intervistimin e fëmijës dhe bën vlerësimin e parë të nevojave të saj/tij, përfshirë vlerësimin e rrezikut nëse ka, nga familjarët e fëmijës apo persona të tjerë.
- Në rast se fëmija rezulton viktimë e mundshme e trafikimit sipas treguesve, dhe informacionit të intervistës, menjëherë pas intervistës, punonjësi kërkon thirrjen e takimit të GTN-së.
- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës/Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës kryen dhe ndërmarrin veprimet konkrete për menaxhimin e rastit të fëmijës, me qëllim garantimin e mbrojtjes apo aksesin e të drejtave të fëmijës.



6. Intervista për identifikimin fillestar të fëmijës si viktimë e mundshme trafikimi

Intervista e identifikimit fillestar

Intervista e identifikimit fillestar është e rëndësishme për të ndaluar shfrytëzimin, për të njohur vuajtjet dhe për t'i dhënë viktimës qasje në ndihmë sa më shpejt të jetë e mundur. Gjithashtu, ajo siguron që njerëzit e referuar tek agjencitë e specializuara dhe që ofrojnë ndihmë për viktimat e trafikimit, janë, në fakt, viktima të trafikimit dhe jo individë të tjerë në një situatë abuzive ose të cenushme, të cilët mund të kenë nevojë dhe të kenë të drejtë për ndihmë dhe/ose mbrojtje tjetër.



6.1 Përgatitjet për intervistën fillestare

Përpara se të intervistoni fëmijën që dyshohet se është viktimë e mundshme e trafikimit, duhet të merrni masat e duhura që intervista të realizohet në mënyrë të sigurtë, etike, dhe me ndjeshmëri ndaj moshës së fëmijës apo ndaj traumave të mundshme që fëmijë mund të ketë kaluar. Për këtë nevojitet që të ndërmerri masat e duhura lidhur me ambientin ku do të bëhet intervista, personat që do të marrin pjesë në intervistë, njoftimin e kujdestarit ligjor/prindit nëse ai nuk është përfishirë në trafikim/abuzim, etj. Më poshtë janë hapat që duhet të ndiqni për përpara se të ndërmerri një intervistë:

- Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve duhet të marrë masa që nëse nuk është në gjendje të komunikojë në gjuhën e fëmijës të sigurojë përkthyes të licensuar dhe autorizuar nga Ministria e Drejtësisë;
- Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës duhet të marrë masa për të siguruar që intervista të kryhet në një vend privat, pa praninë e të tjerëve, me përjashtim të rasteve të të miturve të shoqëruar nga prindërit e tyre;
- Të marrë masa që intervistat të kryhen nga një anëtar stafi i trajnuar posaçërisht;
- Të marrë masa që të ruhet konfidencialiteti dhe të informojë fëmijën dhe kujdestarin ligjor/prindin mbi konfidencialitetin dhe anonimat. Të gjitha palët duhet të firmosin deklaratën e konfidencialitetit. Fëmija dhe kujdestari/prindi duhet të informohen se si do të përdoret informacioni i dhënë;
- Punonjësi që do të realizojë intervistën duhet të marrë pëlqimin e fëmijës dhe kujdestarit ligjor/prindit. Nëse fëmija nuk jep pëlqimin, ai/ajo duhet të jetë i lirë të shkojë. Intervistat mund të zhvillohen me kohën; nuk duhet të përcaktohet menjëherë gjithçka

Intervista për identifikimin fillestar duhet të përmbajë pyetje që lidhen vetëm me qëllimin e identifikimit fillestar (vlerësimin e rrezikut, mbrojtjen, shërbimet). Në intervistën fillestare mbahet një prag i ulët i gjetjeve nëse personi është “viktimë e mundshme trafikimi”.

- ✓ **Intervista** duhet të kryhet duke përdorur modelin që i është bashkëlidhur këtij Udhëzuesi (*Aneksi 5, Formati A.2, A.3, A.5 i PSV-ve*).

- ✓ Intervista duhet të hartohet në formë të shkruar dhe të arkivohet në dokumentet e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës dhe t'i dorëzohet kopje anëtarit përkatës të Autoritetit Përgjegjës (APAP) me e-mail brenda 24 orësh.



6.2 Zhvillimi i intervistës fillestare të fëmijës

- ✓ Intervista të kryhet vetëm pasi fëmijës i janë përmbushur nevojat e menjëhershme dhe ato shëndetësore;
- ✓ Intervista të kryhet në një mjedis miqësor dhe në mënyrë jo agresive dhe nga punonjës të kualifikuar që janë trajnuar më parë për mënyrën e kryerjes së intervistës së fëmijës viktimë e trafikimit;
- ✓ Të ndahet viktimja e mundshme nga vendi ku mund të mbahen trafikantët/shfrytëzuesit e dyshuar ose personat që mund t'i raportojnë. Për këtë qëllim, do të ishte e këshillueshme që të përdoret një dhomë brenda zyrave, ndoshta pa elementë dallues dhe në të cilën të sigurohet që viktimja të mund të plotësojë nevojat e tij parësore;
- ✓ Prania e prindit ose kujdestarit ligjor të lejohet vetëm nëse është në interesin më të lartë të fëmijës dhe nuk ka dyshim të arsyeshëm se është i/e përfshirë në shfrytëzimin e fëmijës;
- ✓ Intervista të realizohet nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës ose Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës së bashku me një punonjës social të bashkisë/njesisë administrative;
- ✓ Gjatë kryerjes së intervistës, gjithmonë merrni parasysh gjendjen e pambrojtur të fëmijës, në lidhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit emocional/njohës/të sjelljes;
- ✓ Fëmija ka të drejtë të dëgjohet dhe t'i merret mendimi në përputhje me moshën dhe aftësinë e saj/tij për të kuptuar;
- ✓ Të informohet fëmija dhe/ose kujdestari për mundësinë e përdorimit të mbrojtësit ligjor dhe mundësinë e përdorimit të ndihmës juridike falas;
- ✓ Të informohet fëmija dhe/ose kujdestari ligjor, duke përdorur një gjuhë të kuptueshme, për format e ndihmës, mbrojtjes dhe shërbimeve të ofruara

Parashtrimi i pyetjeve

Fëmijë të ndryshëm japin sasi të ndryshme informacioni të rëndësishëm gjatë një rrëfimi të lirë. Në pothuajse të gjitha rastet, do të jetë e nevojshme të shtjellohet më tej rrëfimi fillestar i fëmijës me anë të pyetjeve.

Gjatë fazës së pyetjeve është e rëndësishme që:

- ✓ Të kalohet në mënyrë sekuenciale përmes llojeve të pyetjeve të përshtatshme për përgjigjen e fëmijës, duke u kthyer në pyetje të hapura/specifike (shmangni pyetjet udhëzuese);
- ✓ Pyetjet të bëhen një pas një, jo të gjitha bashkë (veçanërisht kur përdorni përkthyes);
- ✓ T'i jepet kohë fëmijës për t'u përgjigjur, por mos harroni shumë gjatë mund të ketë efekt shtypës;
- ✓ Mos ndërprisni;
- ✓ Pyetjet nuk duhet të përsëriten në të njëjtën formë kur përgjigja e parë konsiderohet e pakënaqshme (fëmija mund të përgjigjet për t'i bërë qejfin intervistuesit);
- ✓ Aty ku fëmijët kanë nevoja specifike komunikimi, duhet të ofrohet ndihmë. Duhet të përgatiten skici-me, vizatimet dhe fotografitë për të lehtësuar pyetjet;

- ✓ Duhet të përdoren fjalë që janë të njohura për një të mitur. Nuk mjafton vetëm ta pyesësh një të mitur nëse e kupton një fjalë. Mund të duhet ta verifikoni sa e kuptojnë;

Mbyllja e intervistës

- ✓ Intervistuesi duhet të **verifikojë** me fëmijën që e ka kuptuar saktë rrëfimin. Kjo bëhet duke përdorur atë që ka komunikuar fëmija, jo duke bërë një përmbledhje nga ana e intervistuesit. Duhet treguar kujdes që të mos përçohet mosbesim.
- ✓ Çdo intervistë duhet të ketë një **fazë përfundimtare**. Pavarësisht nga rezultati i intervistës, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të siguruar që fëmija të mos jetë i shqetësuar, por në një gjendje pozitive mendore. Edhe nëse është dhënë pak ose aspak informacion, fëmija nuk duhet të ndihet se ai apo ajo ka dështuar apo se e ka zhgënjyer intervistuesin.
- ✓ **Falënderojeni** fëmijën për kohën dhe përpjekjet dhe pyeteni nëse ka dëshirë të komunikojnë diçka tjetër. Duhet shpjeguar se çfarë ndodh më pas, nëse ndodh diçka, por **nuk duhen bërë premtime për zhvillimet e ardhshme**.

Gjatë gjithë intervistës, dhe veçanërisht në përmblyllje, intervistuesi duhet të jetë i përgatitur ta ndihmojë fëmijën të përballet me efektet e rrëfimit të historisë mbi veten e vet duke qenë se mund të ketë pasur ngjarje shumë shqetësuese, dhe për të cilën fëmija mund të ndjejë një masë faji.

Rekomandohet që intervista dhe raportimi i rastit të kryhen brenda një afati maksimal prej 48 orësh që nga marrja e informacionit fillestar mbi rastin.



6.3 Hapat pas intervistës fillestare të fëmijës

Në qoftë se në përfundim të intervistës kanë dalë tregues pozitivë se **fëmija mund të jetë viktimë trafikiimi**, sipas treguesve, **brenda një afati prej jo më shumë se 24 orësh**, merren këto hapa:

1. Fëmijës i sigurohet strehim i përshtatshëm dhe i sigurt;
2. Vlerësohet mundësia e institucionit/organizatës për ta nxjerrë menjëherë fëmijën nga situata e shfrytëzimit;
3. Ndërhyhet për ta nxjerrë menjëherë fëmijën nga situata e shfrytëzimit/ndërprerje e shfrytëzimit (**vetë apo nëpërmjet punonjësve të policisë së shtetit**);
4. Informohet fëmija apo kujdestari ligjor (në rastet kur nuk përbën rrezik për fëmijën dhe është mbështetës në hapat e ndërmarrë për të siguruar mbrojtjen) për situatën ku ndodhet sipas vlerësimit të punonjësit mbi situatën e tij/saj;
5. Informohet mbi të drejtat dhe ndihmën që mund të japë vetë institucioni për viktimat e trafikimit ose mënyrat e qasjes tek ndihma e institucioneve të mbrojtjes së viktimave;
6. Njoftohet Anëtar i Përkatës i Autoritetit Përgjegjës (APAP)/AShMDF ose drejtuesi/Kryesuesi i Autoritetit Përgjegjës (D/KAP) dhe komunikohet me të lidhur me vendosjen e fëmijës në një mjedis të sigurt që i plotëson nevojat e tij/ saj të menjëhershme;
7. Mbështetet procesi i vendosjes së fëmijës në një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm;
8. Vlerësohet situata shëndetësore dhe referohet tek strukturat shëndetësore;

9. Plotësohet dokumentacioni i identifikimit fillestar dhe dërgohet tek APAP (sipas formatit A2, A3,A5 të PSV-ve);
10. Në rastin e fëmijës së huaj, përfshirë fëmijën e pashoqëruar, informohet për të drejtën në lidhje me lejen e përkohshme të qëndrimit si viktimë e mundshme e trafikimit, sipas legjislacionit për të huajt (Ligji Nr. 79/2021, “Për të Huajt”, neni 53);
11. Mbështetet fëmija në intervistën formale (*shiko identifikimi formal*);
12. Mbështetet procesi i hetimit të trafikantëve;
13. Vijon procesi i mbrojtjes;

Të gjitha procedurat e mësipërme duhet të kryhen edhe nëse fëmija viktimë e mundshme e trafikimit/shfrytëzimit ka kryer vepra penale. Në këtë rast, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës duhet të koordinojë me Prokurorin, i cili do të vlerësojë pozitën e fëmijës.

Gjithashtu rol të rëndësishëm në rastet e fëmijëve viktimë të mundshme të trafikimit/shfrytëzimit të cilët kanë kryer vepra penale luan bashkëpunimi mes Punonjësve të Mbrojtjes së fëmijëve dhe punonjësve të policisë në komisariate përsa i përket shkëmbimit të informacionit dhe marrjen e masave në sigurimin e mbrojtjes së menjehershme kur vlerësohet e nevojshme.



7. Identifikimi formal



7.1 Përse shërben identifikimi formal

Identifikimi formal, është identifikimi i fëmijës **si viktimë trafikimi** i kryer vetëm nga Punonjësi i Policisë i Sektorit për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme dhe Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës, **në bazë të formatit të intervistës formale** të përfshirë në këtë dokument (Aneksi 5, Formati B3 sipas PSV-ve), e cila kryhet me vullnetin e vetë viktimës dhe kur ajo është e gatshme për ta kryer atë.

Ky identifikim kryhet vetëm nga Grupi/Struktura Përgjegjëse për identifikimin formal (G/SPIF) në bazë të formatit të intervistës formale të përfshirë në dokument. Mjeti i vetëm i identifikimit formal është intervista formale/zyrtare.

PSV-të përcaktojnë se identifikimi formal përfshin të paktën:

1. Ndërhyrjen e menjëhershme të Sektorit për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm për kryerjen e intervistës formale, kur njoftohet nga agjencia referuese apo kur vetë viktimja e mundshme e trafikimit shpreh vullnetin pranë strukturave të policisë së shtetit për të kryer intervistën formale;
2. Përcaktimin nëse personi është i/e trafikuar apo jo, nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së informacionit të dhënë nga vetë personi;
3. Vlerësimin në mënyrë të thelluar të nevojave të personit viktimë e trafikimit për ndihmë dhe mbrojtje;
4. Dhënien e udhëzimeve dhe sigurimin e qasjes së personit të trafikuar te ndihma e përshtatshme dhe e sigurt;
5. Grumbullimin e informacionit dhe nisjen e hetimeve për penalizimin e trafikantëve;

PSV-të përcaktojnë se intervista/vërtetimi formal i statusit të personit si i trafikuar ndahet qartë në kohë nga depozitimi i kallëzimit penal. PSV-të përcaktojnë se edhe nëse personi është i gatshëm të paraqesë kallëzim penal, në asnjë rast intervista formale nuk mund të ndërpritet për të marrë kallëzimin penal, por për këtë përcaktohet një kohë tjetër.

Institucionet përgjegjëse për identifikimin formal të fëmijëve:

Institucioni përgjegjës për identifikimin formal është grupi/struktura përgjegjëse për identifikimin formal që kryen intervistimin formal të fëmijëve që identifikohen si viktimja të mundshme të trafikimit, e përbërë nga një punonjës i policisë së shtetit i seksionit të hetimit të trafikeve të paligjshme (SLKTP) dhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve/NJMF në bashki/njësi administrative për çdo rast të të miturve.

Mjeti i identifikimit formal për fëmijët është intervista formale dhe konsultimi i AP-së dhe ASHDMF-së. Nëpërmjet intervistës përcaktohet përfundimisht statusi i fëmijës në lidhje me trafikimin, bëhet vlerësimi i thelluar i nevojave të fëmijës për ndihmë dhe mbrojtje, jepen udhëzime dhe sigurohet qasja e fëmijës së trafikuar te ndihma e përshtatshme afatgjatë dhe e sigurt dhe grumbullohet informacion për nisjen e hetimeve për penalizimin e trafikantëve.

Kushtet e intervistimit formal janë të njejtat si ato të intervistës fillestare!



7.2 Roli i Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës në fazën e Identifikimit Formal

Për kryerjen e intervistës formale të fëmijës, Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës bën kërkesë pranë Sektorit për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme të Drejtorisë Vendore të Policisë. Kërkesa për realizimin e intervistës formale mund të bëhet nëpërmjet komunikimit me shkresë zyrtare apo në formë elektronike.

Afati për konfirmimin e intervistës nga ana e Sektorit për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme është maksimalisht 48 orë.

Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës asiston në çdo rast përgjatë realizimit të intervistës formale të fëmijës. Gjatë përgatitjes për intervistën formale, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës i vendos në dispozicion një relacion përmblendhës Specialistit të Policisë për Hetimin e Trafikeve lidhur me historikun e rastit dhe shërbimet e ofruara.

- ✓ Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës i shpjegon fëmijës (dhe prindit ose kujdestarit) në një gjuhë të kuptueshme qëllimin e intervistës formale si edhe **dallimin midis intervistës formale dhe kallëzimit të veprës penale.**
- ✓ Punonjësi/specialisti i strukturave vendore për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme së bashku me Punonjësën për Mbrojtjen e Fëmijës **zhvillojnë intervistën.**
- ✓ Pas mbylljes së intervistës, punonjësi i policisë dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës, së bashku me punonjësën e agjencisë që ka shoqëruar fëmijën (nëse ka), diskutojnë për statusin e fëmijës në lidhje me trafikimin – **nëse është viktimë e trafikimit.** Në rast të mosrënies dakord, secili prej tyre njofton gojarisht/ me telefon APAP-in, ose në mungesë të tij, D/KAP-in.
- ✓ Punonjësit e strukturave vendore të Policisë së Shtetit për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme dhe të strukturës sociale të bashkisë/PMF veprojnë në përputhje me vendimin.
- ✓ PMF njofton masat që duhen marrë dhe kërkon aprovim nga drejtuesi i strukturës sociale të bashkisë.
- ✓ Pas përfundimit të veprimeve të mësipërme të dy punonjësit hartojnë relacionin për AP dhe ia dërgojnë Sekretariatit të AP-së.

Në çdo rast PMF raporton edhe pranë ASHDMF

Rast ilustrues

Rast referuar nga Institucion i Përkujdesit Rezidencial

Drejtoresha e Shtëpisë së Fëmijës xx në Bashkinë xxx raporton në formë elektronike dhe me telefon pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës rastin e të miturit A.Z, 12 vjeç, i cili është vendosur me masë mbrojtjeje dhe kujdestaria ligjore është e institucionit. Sipas raportimit, në muajt e fundit djali ka sjellje të dhunshme kundrejt fëmijëve në institucion dhe stafit, refuzon të frekuentojë shkollën dhe së fundmi i është gjetur lëndë narkotike në rrobat e tij. Sipas komunikimeve me kujdestaren e institucionit, lëndën narkotike ia jepnin djem më të rritur në moshë për ta shitur kur ai del për të shkuar në shkollë. Gjithashtu fëmija deklaron shuma parash të cilat ua dorëzon këtyre djemve.

Mbi këtë rast Institucioni ka vendosur në dijeni Shërbimin Social Shtetëror dhe Komisaratin më të afërt si dhe APAP.



8. Sigurimi i mbrojtjes së menjëhershme

Sipas VKM 578 i njohur si vendimi mbi menaxhimin e rastit, masa emergjente e mbrojtjes iniciohet nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës nëse, pas referimit apo gjatë vlerësimit fillestar, rezulton se fëmija është:

- Në situatë të rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo forme tjetër dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo të prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku qëndron fëmija nuk është i sigurt për të;
- Braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;
- Pa përkujdesje prindërore, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situata të tilla, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore;

Procedurat e menaxhimit të rastit parashikojnë llojet e rrezikut si më poshtë:

Rrezik i ulët

Një situatë në të cilën fëmija është relativisht i sigurt, nuk vuan nga dëme si rrjedhojë e abuzimit dhe është në gjendje ta mbrojë veten. Megjithatë, mbeten të pranishëm faktorë rreziku dhe fëmija mund të bjerë pre e abuzimit, dhunës, neglizhencës ose shfrytëzimit, nëse nuk merren masa për të ofruar respektim të të drejtave dhe qasje në to ose nëse nuk jepen shërbime.

Rrezik i mesëm

Situata në të cilën gjendet fëmija, për të cilin nuk ka të dhëna që të jetë në rrezik për të pësuar dëmtime të rënda apo të ketë pësuar dëmtime të rënda, por ekziston mundësia që të dëmtohet apo të abuzohet, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur. Ndërhyrja për të mbrojtur fëmijën dhe për të ofruar shërbime është e domosdoshme.

Rrezik i lartë

Situata në të cilën gjendet fëmija rrezikon që të dëmtohet rëndë, të jetë subjekt i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme apo të dëmtohet në mënyrë të tillë që të vuajë nga paaftësi të përhershme ose t'i rrezikohet seriozisht mirëqenia, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur.

Rrezik shumë i lartë (emergjent)

Situata në të cilën gjendet fëmija, i cili, në momentin e identifikimit nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe, nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë, mund të abuzohet seksualisht, të trafikohet apo të jetë pre e keqtrajtimit të tjera, të konsideruara vepër penale, sipas Kodit Penal.

- ✓ Vlerësimi i nivelit të rrezikut bëhet nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës dhe vendimi për marrjen e masës emergjente të mbrojtjes konfirmohet nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në

Bashki.

- ✓ Në varësi të rrethanave të rastit, largimi nga situata e rrezikut dhe vendosja në shërbim emergjent mund të bëhet menjëherë ose realizohet dhënia e një deklarimi në komisarjat e më pas vendosja në shërbim emergjence.
- ✓ Për çdo rast të identifikuar në rrezik të lartë apo emergjent, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës vlerëson së pari nevojat për shërbim shëndetësor, ushqim dhe veshmbathje. Merr gjeneralitetet e fëmijës dhe nëse është e mundur dhe jo në rrezik për fëmijën, vendos komunikim me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës.
- ✓ Në rastet kur të miturit viktimë apo viktimë të mundshme identifikohen në bashki në të cilat mungon shërbimi emergjent, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës koordinon me ASHDMF dhe AP në identifikimin e strukturës pritëse për ofrimin e shërbimit emergjent.
- ✓ Marrja e shërbimit emergjent mund të zgjasë në varësi të rastit 72 orë deri në 11 ditë sipas afateve për ndjekjen e procedurave për mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial apo aplikimin e një mase mbrojtje nëse do të jetë e nevojshme.
- ✓ Qëllimi i ndihmës emergjente është që fëmija të qëndrojë në një ambient të sigurt prej dëmtimit dhe rreziqeve të trafikimit, që situata e fëmijës të vlerësohet në mënyrë tërësore dhe të thelluar, që fëmija të marrë shërbime që takojnë nevojat bazë dhe që të përgatitet terreni për trajtimin e nevojave afatmesme dhe afatgjata të tij/saj.

Shërbimet e emergjencës ndihmojnë në:

- Marrjen e fëmijës nga ambienti i identifikimit – kryesisht komisarjate;
- Pritjen dhe orientimin në qendër/strehëz emergjence;
- Stabilizimin emocional dhe adresimin e menjehershëm të nevojave bazë – ushqim , veshje , gjumë, higjenë;
- Vlerësimin e nevojave dhe Planifikimi i ndihmës në bashkëpunim me PMF;
- Ushqimin, fjetjen, larjen e trupit, larjen e rrobave , higjenën personale dhe higjenën e ambientit;
- Kontrollin mjekësor dhe administrimin e mjekimit në shtëpi;
- Këshillim/konsultim;
- Aktivitete loje mësimi rekreacion;
- Kontakte me familjen;
- Shoqërim gjatë intervistave me zbatuesit e ligjit, seancave gjyqësore

Hapat e punonjësve të qendrës së emergjencës:

- Një punonjës social ose psikolog i qendrës bën menjëherë pranimin e të miturit/të miturës;
- Një punonjës social ose psikolog i qendrës e njeh menjëherë, të miturin/ën dhe kujdestarin apo prindin, në rast se është me të, me ambientet e qendrës;
- Një mjek i qendrës së emergjencës bën ekzaminimin e fëmijës e në mungesë të tij kërkohet, nëse është e domosdoshme, ndihma e shërbimit shëndetësor të urgjencës;
- Punonjësi i rastit (punonjës social ose psikolog) referon rastin të NJMF pasi plotëson nevojat bazë të të miturit;

- Në rast të largimit të të miturit nga qendra pa leje, punonjësi njofton menjëherë APAP dhe NJMF, si dhe bën kallëzimin në polici;
- Në rast të kthimit do të kërkohet një vlerësim të situatës social ekonomike njësoj si për kthimin e fëmijës nga jashtë;
- Në rast të kthimit të të miturit në familje/familjen kujdestare punonjësi njofton menjëherë APAP dhe NJMF

Rast ilustrues

Fëmija D.D, 16 vjeç, paraqitet pranë një organizate për të kërkuar ndihmë mjekësore pasi është dhunuar dhe abuzuar nga persona të tjerë. Menjëherë stafi i organizatës vendos në dijeni Punonjësen për Mbrojtjen e Fëmijës dhe fëmija merr shërbimin e nevojshëm shëndetësor. Në bazë të vlerësimit të mjekëve, fëmija ka sëmundje seksualisht të transmetueshme, vuan nga prapambejtje e moderuar e shëndetit mendor si dhe është përdorues i lëndëve narkotike. Fëmija deklaron se lënda narkotike i sigurohej nga një person madhor i cili ishte dhe partner i saj.

Nga informacioni i marrë, i mituri identifikohet si transgjjinor dhe prej një viti jeton me një grup vajzash më të mëdha në moshë pasi ishte i braktisur nga familja e tij.

Menjëherë pas referimit rasti merret në mbrojtje të menjëhershme duke i ofruar shërbimin shëndetësor, më tej vendosur në qendër emergjence.

Mbi rastin vihet në dijeni ASHMDF dhe AP.



9. Periudha e rehabilitimit dhe e riintegritimit



9.1 Riintegrimi

Riintegrimi i referohet procesit të rikuperimit dhe përfshirjes sociale pas një eksperience trafikimi. Kjo përfshirje është shumëdimensionale dhe duhet të ndërmerret në aspektet sociale, kulturore dhe ekonomike.

Riintegrimi përfshin vendosjen në një ambient të sigurt, aksesin në standarde të arsyeshme jetese, mundësitë për zhvillim personal dhe ekonomik, si edhe aksesin në mbështetjen emocionale dhe sociale. Në rastin e fëmijëve të huaj, riintegrimi përfshin kthimin e viktimës në familjen e origjinës/ komunitetin e origjinës. Megjithatë, mund të përfshijë gjithashtu integrimin në një vend të ri, në varësi të nevojave të viktimës.

Aspekti qendror i riintegritimit të suksesshëm është **fuqizimi**, mbështetja e viktimave për të zhvilluar aftësi drejt arritjes së pavarësisë dhe vetëmjaftueshmërisë, si edhe përfshirja në mënyrë aktive në rikuperimin dhe riintegrimin e tyre (Surtees 2006).

Faktorë që ndikojnë në riintegrimin e fëmijëve janë:³

- Moshë e fëmijës;
- Pjekuria e fëmijës dhe faza e zhvillimit;
- Edukimi i fëmijës dhe kapaciteti mendor;
- Kohëzgjatja e abuzimit të fëmijës;
- Natyra e abuzimit;
- Fakti nëse trafikanti/shfrytëzuesi ka qënë i njohur për fëmijën, përfshirë anëtarë të familjes;
- Nëse fëmija mund të ndihmohet nga familja/apo ka mbështetje sociale

³ Rebecca Surtees, Re/integration of trafficked persons. Working with trafficked children and youth, 2014. Issue paper #5 Trafficking Victims Re/integration Programme (TVRP).

Parimet etike në ri/integrimin e personave të trafikuar⁴

Parimi #1. “Mos dëmto”

Parimi #2. Leje e informuar

Parimi #3. Konfidencialiteti

Parimi #4. Anonimiteti

Parimi #5. Privatësia

Parimi #6. Mos-diskriminimi

Parimi #7. Siguria

Parimi #8. Ndjeshmëria

Parimi #9. Fuqizimi

Parimi #10. Pjesëmarrja e përfituesit/ses

Parimi #11. Mbrojtja e të dhënave

Parimi #12. Mbrojtja e fëmijëve dhe “Interesi më i lartë për fëmijët”

Parime të rëndësishme që duhet të merren në konsideratë për ri-integrimin e fëmijëve⁵

- Prioritizim i bashkimit me familjen dhe të qenit fëmija në qendër
- Ndërmerrni riintegrimin në sisteme më të gjëra të mbrojtjes së fëmijës
- Ndërmerrni qasje të bazuar tek të drejtat e fëmijëve
- Mos dëmto
- Angazhoni një numër të konsiderueshëm aktorësh

Paketa minimale e shërbimeve riintegruese përfshin:

- Strehim i përshtatshëm dhe i sigurtë;
- Asistencë psikosociale/Këshillim psikologjik;
- Ndihmë mjekësore;
- Ndihmë për ri-futjen në sistemin shkollor;
- Trajnim profesional;
- Këshillim dhe ndihmë për punësim;
- Programe pune që krijojnë të ardhura;
- Zhvillim të aftësive për jetën gjatë ri-integrimit;
- Këshillim dhe mbrojtje ligjore;

⁴ Rebecca Surtees. Ethical principles for the re/integration of trafficked persons. Experiences from the Balkans, KBF and NEXUS 2012.

⁵ Inter-agency Working Group on Children Reintegration, Guidelines on Children Reintegration, 2016.

- Mbështetje familjes/Ndërmjetësim me familjen;
- Masat e riintegritit në familje/ komunitet;
- Informacion mbi shërbimet që ekzistojnë në komunitet si dhe kontaktet e nevojshme/hartën e shërbimeve;
- Ndhimën specifike për rastet me nevoja të veçanta (rastet me fëmijë, kujdes i paralindjes, kur është shtatzënë; për rastet me probleme sigurie; për rastet me probleme të shëndetit mendor; për rastet që kanë abuzuar me substanca etj);
- Monitorim dhe vlerësim i rastit;

Procesi i riintegritit për fëmijët e trafikuar duhet të fillojë gjithmonë me një vlerësim të **interetit më të lartë të fëmijës** në mënyrë që të sigurohet që çdo plan ndihme i shërben këtij parimi. Ky vlerësim i interetit më të lartë duhet të ndërmerret me kujdes nga profesionistë të trajnuar dhe sipas një qasje multidisiplinare, dhe duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e e rastit.

Sipas Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës“, **interesi më i lartë i fëmijës** nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.

Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysht:

- nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritja/përkatësia në një familje;
- mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- historia e fëmijës, duke mbajtur parasysht situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
- aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t’u përgjigjur nevojave të fëmijës;
- vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore;

Plani i ndihmës duhet të zbatohet brenda kornizës së sistemit të mbrojtjes së fëmijëve për të zhvilluar mundësi që i përgjigjen më mirë çdo fëmije individualisht.



9.2 Çështje dhe konsiderata të veçanta në ndihmën e fëmijëve të trafikuar në fazën e riintegritit dhe përfshirjes⁶

Kohëzgjatja e procesit të riintegritit: Procesi i riintegritit të fëmijëve ka tendencën të jetë më i gjatë se te të rriturit. Kjo ndodh për shkak se ndikimi i trafikimit te fëmijët është shpesh më i madh se te të rriturit, siç shpjegohet më poshtë, dhe ata kërkojnë më shumë kohë për t’u rikuperuar. Gjithashtu, ndodh për shkak se shërbimet që ata kanë nevojë, si arsimit formal, kanë kohëzgjatje më të madhe. Krahas mbështetjes arsimore, ata kanë zakonisht nevojë për formim profesional për t’u përgatitur për të ardhmen dhe mundësitë për punësim.

Ndikimi i trafikimit te fëmijët: Fëmijët kanë aftësi më pak të zhvilluara të përballimit sesa të rriturit, dhe rrjedhimisht ndikimi i trafikimit te fëmijët ka gjasë të jetë më i madh. Fëmijët e trafikuar janë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të abuzimit dhe traumës, dhe kërkojnë trajtim dhe monitorim për një periudhë më të gjatë. Mënyra, kohëzgjatja dhe intensiteti i trafikimit tregon se sa ndikohet një fëmijë. Sa më e gjatë koha e

⁶ Sipas “Fazat e rikuperimit dhe riintegritit të viktimave të trafikimit. Udhëzues riintegritit për profesionistët”, botim i organizatës “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”, <https://differentandequal.org/ep-content/uploads/2022/04/1.-Fazat-e-rikuperimit-dhe-riintegritit-te-viktimave-te-trafikimit.pdf>

trafikimit të fëmijës, aq më e gjatë koha e rikuperimit dhe rrjedhimisht më e madhe vigjilenca e këtyre fëmijëve. Sa më gjatë të trafikohet një fëmijë, aq më e gjatë është koha e riintegritit dhe rrjedhimisht aq më shumë vëmendje dhe mbështetje nevojitet.

Gjetja e zgjidhjeve të qëndrueshme: Kur fëmijët nuk janë në gjendje të kthehen në familjen e tyre, kjo e ndërlikon më tej riintegrimin dhe përfshirjen pasi ka mundësi të kufizuara për kujdes afatgjatë dhe strehimi rezidencial nuk është i përshtatshëm për riintegrimin afatgjatë të fëmijëve. Nëse fëmijët nuk jetojnë së bashku me familjen, nevojiten mundësi të tjera akomodimi.

Përfshirja në aktivitete komunitare të rinjve: Është e rëndësishme që fëmijët të angazhohen në mënyrë aktive në jetën e tyre të përditshme. Përfshirja në aktivitetet komunitare mund të nxisë vetëbesimin dhe vetëlerësimin e tyre, dhe t'i ndihmojë ata të zhvillojnë aftësi sociale dhe ndërpersonale, si dhe të rritin ose forcojnë rrjetin e tyre social.



9.3 Plani individual i mbrojtjes

Referuar praktikës së rasteve të menaxhuara nga Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës, Planet Individuale të Mbrojtjes për fëmijët e trafikuar ndërtohen bazuar në situatën individuale të çdo fëmije:

Plani i mbrojtjes bazohet në vlerësimin e nevojave dhe ndërtimin e planit të ndihmës si në situata kur **fëmija ndihmohet në familje**, dhe në situata kur **fëmija ndihmohet në një institucion rezidencial**.

Vlerësimi i thelluar i nevojave është shumë i rëndësishëm për të ndërtuar një plan individual të mbrojtjes dhe riintegritit.

Vlerësimi duhet të përfshijë të paktën:

- Vlerësimin e sigurisë;
- Të nevojës për strehim;
- Vlerësimin e familjes;
- Vlerësimin e nevojave psikologjike, shëndetësore, ligjore;
- Nevojën për shkollim apo programe të tjera edukimi, formim profesional dhe aspekte të tjera të fuqizimit ekonomik;

a) Fëmija asistohet në familje

Në rastet kur Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës, nëpërmjet vlerësimit të plotë, krijon bindjen se **qëndrimi pranë familjes është në interesin më të lartë të fëmijës dhe ambjenti i shtëpisë nuk cënon sigurinë dhe mirëqënien e të fëmijës**, nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

- Marrje e informacionit nga të gjithë personat që kanë dijeni mbi rastin;
- Vizita në familje;
- Vlerësimi i faktorëve të rrishtit;
- Vlerësim që familja është mbështetëse, situata familjare socio-ekonomike është e favorshme;
- Fëmija shpreh dëshirën për të qëndruar në familje;

Nëse vlerësimi i qëndrimit të fëmijës në familje është pozitiv, fëmija vijon të asistohet në ambjentin familjar.

Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës, pasi ka realizuar vlerësimin e plotë nëpërmjet vizitave në familje dhe takimeve me persona/institucione të cilat janë në dijeni të rastit ose mund të ndihmojnë në plotësimin e informacionit,

të dhëna të cilat kanë ndihmuar në përcaktimin e nivelit të rrezikut dhe vendimit për qëndrimin e fëmijës në familjen, thërret mbledhjen e Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN). Në mbledhje duhet vlerësuar me prioritet dhe pjesëmarrja e familjes dhe fëmijës.

Të gjithë pjesëmarrësit në GTN vlerësojnë problematikat dhe nevojat që ka i mituri/familja, më pas caktojnë ndërhyrjet dhe shërbimet që do ofrohen nga secili aktorë bazuar në afatet kohore të caktuara. Monitorimi i ecurisë së Planit Individual të Mbrojtjes (PIM) kryhet nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës. Plani Individual i Mbrojtjes parashikon ndërhyrje në:

- Nevojat për siguri;
- Strehimi/akomodimi dhe nevojat bazë;
- Shëndeti dhe nevoja për zhvillim (duke përfshirë nevojat fizike, emocionale dhe psikologjike);
- Arsimi dhe aftësitë e jetës;
- Marrëdhëniet sociale;
- Marrëdhëniet Familjare (përfshirë si do të mbahen kontaktet nëse fëmija do të shkëputet nga familja);
- Kulturor/identiteti;
- Nevojat për aktivitete shlodhëse;
- Çdo lloj tjetër i veçantë nevoje (p.sh., konsultime etj. për të ndihmuar në përmirësimin e situatës);

Në rastet e menaxhimit në familje, zakonisht GTN propozon për të miturin marrjen e masës së mbrojtjes “Mbikqyrje në Ambjentin Familjar” (Neni 58, ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”).

Duhet theksuar se këto ndërhyrje nuk janë kufizuese por rast pas rasti mund të ketë nevoja për ndërhyrje apo shërbime të ndryshme.

Afatet e rishqyrtimit të PIM janë të parashikuara në VKM 578/2018 (*jo më vonë se 6 javë pas hartimit të PIM-it të parë dhe, më pas, çdo 3 muaj, por sipas nevojave të rastit ose kërkesës së njërit prej anëtarëve të GTN-së rishqyrtimi mund të bëhet më shpesh*).

b) Fëmija asistohet në strehëza/qendrat për viktimat e trafikimit

Në rastet kur nga informacionet e marra dhe vlerësimit të kryer rezulton **që fëmija nuk mund të qëndrojë në ambjentin familjar për shkak se i cënohet siguria dhe mirëqënia, familja nuk është bashkëpunuese ose vetë fëmija refuzon të kthehet në familje**, atëherë merret vendimi për t'u vendosur në strehëza/qendrat për viktimat e trafikimit.

Vendosja e fëmijës në strehëza/qendrat për viktimat e trafikimit kryhet në dy mënyra:

1) Me masë mbrojtje të propozuar nga GTN

Ky proces ndiqet sipas parashikimeve në ligj 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, ku masa pasi është konfirmuar nga Drejtori i Strukturës Përgjegjëse në Bashki, depozitohet në gjykatë për konfirmim të vlefshmërisë së masës së mbrojtjes dhe vendosjes në kujdestari.

Në këto raste, kujdestaria e përkohëshme e të miturit i kalon strehëzës/qendrës për viktimat trafikimi.

2) Vendosja në një strehëz/qendër për viktimat të trafikimit për marrjen e shërbimeve të një tipologjie të caktuar si pjesë e zbatimit të PIM.

Kjo procedurë ndiqet kur familja e fëmijës është mbështetëse dhe bashkëpunuese, por fëmija nuk mund të qëndrojë në ambjentin familjar për shkak të sigurisë ose mungesës së bashkëpunimit nga ana e tij dhe vështirësisë për rehabilitim dhe riintegrim. Kjo procedurë nuk sjell ndryshime kujdestarie, por duhet dakortë-

simi i kujdestarëve ligjorë për akomodimin e fëmijës në strehëz. Në rastet kur fëmija vendoset në strehëz, menaxhimi dhe hartimi i planit të ndërhyrjes kryhet nga punonjësit e institucionit, të cilët vlerësojnë edhe pjesëmarrjen e PMF. Gjithmonë para daljes së të miturit, institucioni duhet të bashkëpunojë me PMF/NJVNR për kryerjen e vlerësimeve nga ana e tyre dhe marrjes së përbashkët të këtij vendimi. Mbështetja e të miturit duhet të vazhdojë edhe në komunitet/familje pas daljes nga strehëza (të paktën 6 muaj).

Dëshira e fëmijës/ bashkëpunimi me familjen

Për fëmijët mbi moshën 14 vjeç vendimet merren pasi është marrë pëlqimi i fëmijës, gjithmonë duke vlerësuar zhvillimin dhe interesin më të lartë të tij. Nëse pëlqimi i fëmijës, cënon sigurinë dhe mirëqënien e tij, atëherë GTN vendos duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës dhe jo vetëm pëlqimin e tij.

Në praktikën e ngritur nga strehëzat/qendrat për viktimat e trafikimit, miratimi i prindërve për marrjen e shërbimit rezidencial është një prej kriterëve. Por nga rastet e menaxhuara, jo gjithmonë ekziston bashkëpunimi i prindërve apo ka raste kur vetë prindi/kujdestari ligjor mund të jetë shfrytëzuesi i fëmijës.

Nëse prindërit/kujdestarët ligjor nuk bashkëpunojnë ose nuk janë të pranishëm për të ushtruar përgjegjësitë e tyre, atëherë grupi teknik ndërsektorial vendos për marrjen në mbrojtje të fëmijës, duke u udhëhequr nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Raste ilustrues

Rast i ndjekur në familje

Fëmija S.H, i ditëlindjes 30.11.2011, jeton në një banesë me qira në Tiranë së bashku me nënën, e cila është e divorcuar, gjyshërit, dy vëllezërit dhe motrën e tij.

Nëna është e punësuar në një subjekt privat, ku përfiton të ardhura rreth 45,000 lekë në muaj, nëpërmjet të cilave siguron jetesën për veten dhe fëmijët e saj. Prindërit janë të divorcuar prej 6 vitesh dhe fëmijët nuk kanë kontakte me babain, për ta kujdeset nëna dhe gjyshërit. Të ardhurat e familjes sigurohen nga puna e nënës dhe pensioni i gjyshërve. Fëmija S.H është larguar shpesh nga banesa, ku në të gjitha rastet nëna e tij ka kryer denoncimin në Komisaratin e Policisë nr.x Tiranë. Nisur nga raportimet e policisë, fëmija është identifikuar se ka kryer disa vjedhje, është përdorues i lëndëve narkotike si dhe është identifikuar që ka ushtruar lypësinë në orët e vona në disa zona të Tiranës.

PMF thërret GTN dhe ndërtohet Plani Individual i Mbrojtjes:

- Nevojat për siguri – Kallëzim në polici nga nëna për personat e dyshuar se shfrytëzojnë të miturin për lypje dhe shitje narkotikësh;
- Strehimi/akomodimi dhe nevojat bazë – referim për bonus qiraje të bashkisë;
- Shëndeti dhe nevoja për zhvillim (duke përfshirë nevojat fizike, emocionale dhe psikologjike) – ndjekje e vizitave pranë detoksikologjisë, mbështetje me këshillim psikologjik për nënën dhe fëmijët;
- Arsimi dhe aftësitë e jetës – mbështetja e psikologes së shkollës mbi rikthimin në shkollë;
- Marrëdhëniet Familjare – ndjekja e klasave të prindërimit dhe terapi këshillimi prind/fëmijë;
- Nevojat për aktivitete shlodhëse – regjistrimi dhe frekuentimi i klubit të futbollit;
- Çdo lloj tjetër i veçantë nevojë (p.sh., konsultime etj. për të ndihmuar në përmirësimin e situatës);

Rast në qendër rezidenciale

I mituri E.K shoqërohet shpesh në komisarate të ndryshme të Tiranës për shkak se përfshihet në vepra të ndryshme penale, kryesisht vjedhje në bashkëpunim dhe me të mitur të tjerë. Fëmija është nën moshën e përgjegjësisë penale. Nga vlerësimet e bëra nga specialistët që kanë qenë në kontakt me fëmijën, ka dyshime se fëmija mund të përdoret fëmijë dhe të rritur të tjerë për të vjedhur. Fëmija është në rrezik të lartë për trafikim apo abuzim seksual. Fëmija është braktisur që në vogëli nga prindërit, është rritur nga gjyshërit nga ana e babait, të cilët shprehen që nuk kanë fuqi kontrolli dhe edukimi mbi të, ndërkohë që me nënën nuk ka marrëdhënie. Ajo jeton në Francë. Nga verifikimet e bëra në regjistrin e gjendjes civile, rezulton se fëmija është me atësi të panjohur.

PMF thërret GTN dhe merret vendimi për vendosjen pranë një strehëze për viktimat e trafikimit. Stafi social i qendrës realizon takim prezantues me fëmijën në prezencë të PMF-së dhe koordinojnë për shoqërimin dhe vendosjen në strehëz ku:

- Një punonjës social ose psikolog i qendrës bën menjëherë pranimin e të miturit/ të miturës.
- Një punonjës social ose psikolog i qendrës e njeh menjëherë të miturin/ën dhe kujdestarin apo prindin, në rast se është me të, me ambientet e qendrës.
- Punonjësit e qendrës menjëherë plotësojnë nevojat bazë të të miturit/miturës.
- Drejtuesi i institucionit rezidencial cakton një punonjës/menaxher të rastit, i cili do të **hartojë një plan individual ndihme për rastin në bashkëpunim me ekipin multidisiplinar të institucionit.**
- Menaxheri i rastit në një gjuhë të kuptueshme për të miturin i shpjegon planin e ndihmës.
- Menaxheri informon kujdestarin ligjor për planin e ndihmës (pasi verifikon se ai nuk është i përfshirë dhe nuk është i dyshuar për trafikimin apo shfrytëzimin e të miturit).
- Pas akomodimit, brenda tri ditëve informohet rasti në lidhje me intervistën formale.
- Menaxheri i rastit njofton APAP për organizimin e intervistës formale.
- Në rast të largimit të të miturit nga qendra pa leje, menaxheri i rastit njofton menjëherë APAP dhe bën kallëzimin në strukturat vendore për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme.

Menaxheri i rastit bashkëpunon me NJMF dhe PMF verifikon që fëmijës i jepen shërbimet e nevojshme dhe rivlerëson periodikisht situatën se tij/saj.



10. Dokumentimi i rasteve



10.1 Procedura e ruajtjes dhe dokumentimit të të dhënave

Neni 16 i VKM 578/2018 parashikon procedurën e ruajtjes dhe dokumentimit të të dhënave të rasteve të menaxhuara nga PMF.

Të gjitha të dhënat, informacioni, veprimet, ndërhyrjet e ndërmarra, shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura gjatë procesit të menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje dokumentohen nga strukturat përkatëse në nivel vendor dhe qendror.

Të gjitha të dhënat dhe informacioni i përfituar ruhen, përpunohen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve nënligjore përkatëse, duke zbatuar detyrat dhe procedurat e parashikuara në këtë vendim.

Detyrimi për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale shtrihet për të gjithë personat dhe institucionet e përfshira në procesin e menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje.

PMF u shpjegon fëmijës dhe anëtarëve të familjes që informacioni që ajo merr, lidhur me identifikimin dhe trajtimin e rastit, nuk mbahet sekret, por regjistrohet në dosjen individuale të fëmijës. Informacioni i marrë përdoret për ndërmarrjen e veprimeve, të ndërhyrjeve dhe dhënien e shërbimeve për fëmijën në nevojë dhe për anëtarët e familjes, duke ruajtur konfidencialitetin ndaj personave të tjerë dhe ndaj publikut në përgjithësi, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. PMF u shpjegon atyre se informacioni do të ndahet vetëm kur dhe në masën që është e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës dhe pasi të jetë informuar fëmija dhe familja.

Çdo anëtar i GTN-së, i përfshirë në menaxhimin e rastit, nënshkruan një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit në mbledhjen e parë të GTN-së.

PMF krijon, për të gjitha rastet në menaxhim, dosjen individuale të fëmijës, e cila mbahet, administrohet dhe ruhet në dosjen individuale:

- a) **Të fëmijës**, e cila është në format letre dhe përmban nënshkrimet origjinale në dokumentet përkatëse;
- b) **Në format elektronik**, e cila përmban të dhëna dhe informacion të përditësuar në formularët elektronikë (Regjistrin Elektronik të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror), sipas formularëve të përcaktuar në këtë vendim, si dhe dokumentet me nënshkrime origjinale të skanuara;
- c) PMF **hap dhe administron dosjen individuale** të fëmijës për të gjitha rastet kur fëmija rezulton në nevojë për mbrojtje dhe është në rrezik të mesëm, të lartë apo të menjëhershëm
- d) PMF **nuk hap dosje individuale të fëmijës në rast se**, pas vlerësimit fillestar, rezulton se fëmija nuk është në nevojë për mbrojtje. Në këto raste, PMF-ja do të marrë masa për referimin e fëmijës pranë institucioneve përgjegjëse për ndjekje të situatës apo ofrimin e shërbimit të nevojshëm. Informacioni dhe të dhënat e rastit do të hidhen në regjistrin elektronik të posaçëm;

NJMF merr masa dhe mbikëqyr PMF-në, në lidhje me hedhjen e të dhënave dhe të informacionit për fëmijët në nevojë për mbrojtje në dosjet individuale përkatëse.

NJMF i raporton dy herë në vit, më 30 maj dhe 30 nëntor, drejtorit të strukturës së shërbimeve shoqërore, në lidhje me të dhënat statistikore për situatën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, bazuar në rezultatet e nxjerra nga regjistri elektronik për fëmijët në nevojë për mbrojtje. Drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki i paraqet këto rezultate në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, ku diskutohet buxheti dhe kërkon përditësimin e fondit për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës, nëse kjo është e nevojshme.



10.2 Dosja individuale e fëmijës në nevojë për mbrojtje

Dosjes individuale të fëmijës në nevojë për mbrojtje i caktohet numri individual, i cili është numri identifikues i fëmijës përgjatë gjithë procesit të menaxhimit të rastit.

Dosja individuale përmban:

- Aneksin 1. Formulari për identifikimin proaktiv;
- Aneksin 2. Formulari i raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje;
- Aneksin 3. Formulari i vlerësimit fillestar;
- Aneksin 4. Formulari për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime;
- Aneksin 5. Formulari i intervistimit;
- Aneksin 6. Formulari i vlerësimit dhe analiza e rrezikut;
- Aneksin 7. Formulari i PIM-it;
- Aneksin 8. Formulari i shqyrtimit të progresit dhe PIM-i i rishikuar;
- Aneksin 9. Formulari i mbylljes së rastit;
- Aneksin 10. Procesverbali për marrjen e fëmijës në mbrojtje të menjëhershme;
- Aneksin 11. Formulari i miratimit për ndarjen e informacionit;
- Aneksin 12. Formulari "Fletë të ditarit", në të cilin pasqyrohen në mënyrë të detajuar datat dhe orët e të gjitha kontakteve me familjen/ fëmijën ose me anëtarët e GTN-së, përfshirë përmbledhjet e diskutimeve, të takimeve dhe vizitave në shtëpi;
- Informacione të tjera të rëndësishme, si certifikata e lindjes, vendimet gjyqësore etj.;
- Procesverbale të shërbimeve, procesverbale të marrjes në mbrojtje dhe kthimit të fëmijës në familje

Të dhënat në format letre ruhen në një mjedis të sigurt, të aksesueshëm vetëm nga PMF. Të gjithë formularët e plotësuar me dorë duhet të plotësohen me stilolaps dhe jo me laps, duke përdorur shkrim të qartë e të kuptueshëm për një lexues tjetër.

PMF merr masa të plotësojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë, dosjen individuale të fëmijës.

